



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

Njoftim Për Shtyp

Rasti: Krijimi i sipërmarrjes së përbashkët të tre shoqërive të reja (Joint Venture) me funksione të plota dhe kontroll të përbashkët nga LG Electronics Inc. dhe Lufthansa Technik AG.

Autoriteti i Konkurrencës me shkresën Nr. 671 Prot., protokoll i AK, datë 22.11.2018 “Shkresë përcjellëse për depozitimin e një njoftimi përqendrimi”, është njoftuar në lidhje me përqendrimin e realizuar mes LG Electronics Inc. dhe Lufthansa Technik AG, nëpërmjet themelimit të një sipërmarrje të përbashkët (joint venture) me funksione të plota dhe kontroll të përbashkët (“SP”).

LG Electronics Inc., është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Kores, me objekt prodhimin dhe shitjen e aparaturave dhe pajisjeve elektronike, pajisjeve të komunikimit, pajisjeve elektrike, biznese të minierave, import-eksportit, faktoringut, leasing i aparaturave dhe pajisjeve elektronike dhe elektrike, shërbime të instalimit të rrjetit të internetit, të instalimit të elektricitetit, prodhimi dhe shitja e kamerave dhe pajisjeve optike etj .

LG Electronics Inc., është pjesë e grupit LG dhe është një nga liderit botërorë të prodhimit dhe inovacionit të teknologjisë për pajisjet elektronike të konsumit.

Lufthansa Technik AG është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Gjermanisë, regjistruar në regjistrin tregtar të gjykatës së rrethit të Hamburgut, me objekt të shoqërisë; kryerja dhe marketingu i shërbimeve të inxhinierisë të aviacionit dhe të gjitha shërbimeve në lidhje me to, veçanërisht mirëmbajtja, riparimi dhe rregullimi i pajisjeve aeronautike si dhe shërbimet e logjistikës, inxhinierisë, kërkimit dhe zhvillimit dhe shërbimet ndihmëse të lidhura për linjën ajrore dhe pronarëve të tjerë të avionëve.

Lufthansa Technik AG është pjesë e grupit Lufthansa dhe një nga shoqëritë më të mëdha të ofrimit të shërbimeve të mirëmbajtjes, ndreqjes dhe rishikimit për avionë, makineri dhe pjesë përbërës si dhe një zhvillues dhe prodhues i sistemeve të kabinës.

Në datën 23 tetor 2018 është nënshkruar “Marrëveshja Joint Venture” në lidhje me Projektin Aeroplay, ndërmjet shoqërisë LG Electronics Inc. dhe shoqërisë Lufthansa Technik AG.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.